



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Rektor

Prof. Dr. Marjan DEMA

Nr. Prot.:

3/424

Datë:

17/11/2017


Senati i Universitetit të Prishtinës referuar në marrëveshjen Nr.191/01B të datës 13.5.2015 në mbledhjen e XXX-të të mbajtur më datën 31.10.2017, mori

V E N D I M

- I. Studentët e degëve të Fakultetit Juridik, Fakultetit Ekonomik dhe të Fakultetit të Edukimit, qendra në Mitrovicë, të regjistruar në kuadër të UP-së në vitin akademik 2013/14, nga viti akademik 2017/18 do të transferohen me të gjitha të drejtat, detyrimet në kuadër të fakulteteve përkatëse në Prishtinë.
- II. Studentët e degëve të Fakultetit të Edukimit, Fakultetit Juridik dhe Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, qendra në Mitrovicë, të cilët dëshirojnë të transferohen në fakultetet përkatëse në kuadër të Universitetit Mitrovicës Isa Boletini në Mitrovicë (UMIB), duhet të bëjnë kërkesë pranë fakulteteve gjegjëse në UMIB-Mitrovicë.
- III. Studentëve të transferuar nga UP në UMIB, në përputhje me marrëveshjen Nr.191/01B të datës 13.5.2015, UMIB do t'i siguroj kushtet akademike dhe infrastrukurore deri në diplomimin e tyre.
- IV. Studentët si në pikën III të këtij vendimi, pas diplomimit do të pajisen me diplomë të UMIB-Mitrovicë.
- V. Administrata e fakulteteve përkatëse e UP-së dhe UMIB-it-së, do të bëjnë transferin e dosjeve të kandidatëve të transferuar në kuadër të fakulteteve përkatëse të UP-së në Prishtinë.
- VI. Shërbimi i teknologjisë informative i fakulteteve përkatëse të UP-së në Prishtinë, obligohet që menjëherë të filloi futjen/migrimin e të dhënave në SEMS për të gjithë studentët e transferuar nga dega e Mitrovicës në UP-Prishtinë.
- VII. Studentëve të transferuar si në pikën I të këtij vendimi, duke filluar nga afati i plotësues nëntorit, do t'iu mundësohet paraqitja dhe hyrja në provimet e mbetura, në kuadër të fakultetit përkatës në Prishtinë.
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Senat.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Dekanëve të njësive akademike të UP-së dhe UMIB-it;
3. Sekretarëve të njësive akademike të UP-së;
4. Sekretarit të përgjithshëm të UP-së dhe UMIB-it;
5. Për publikim në ueb-faqe.



Prof. dr. Marjan Dema

Kryesues i Senatit të UP-së